



Në bazë të nenit 13.7, 14.7, lidhur me nenin 16.2 dhe të nenit 19.2 të Ligjit për planifikimin hapësinor nr. 2003/14, të datës 03.07.2003, të shpallur sipas Rregullorës nr. 2003/30, dt. 10. 09.2003, të nenit 3, par. 1, pika b, të Rregullorës mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës nr. 2000/45, të dt. 11 gusht 2000, të nenit 19, par.1, pika b,dhe të nenit 40, par. 3, pika II. të Statutit dhe të rregullave të procedurës të Komunës së Prishtinës, të dt. 16.03.2001, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 18.10.2005 merr

V E N D I M

PËR MIRATIMIN E PROJEKTIT IDEOR TË PLANIT RREGULLATIV “QENDRA-ULPIANA” NË PRISHTINË

Neni 1

Miratohet projekti ideor i Planit rregullativ “Qendra-Ulpiana” në Prishtinë.

Projekti ideori i Planit, nga alinea 1 e këtij neni, është zgjedhur nga komisioni për vlerësimin teknik të firmave projektuese, pjesëmarrëse në konkursin e shpallur nga Komuna nr.05098411, dt. 19.05.2005, i punuar nga firma projektuese “ Horizons-group” nga Prishtina.

Neni 2

Me projektin ideor të Planit rregullativ, nga neni 1 i këtij Vendimi, rregullohet kompleksi “Qendra-Ulpiana” në Prishtinë, i cili përfshinë hapësirën në mes të rrugëve “Bulevardi i Dëshmorëve” dhe “Imzot Nikë Prela”.

Hapësira, nga par. 1 i këtij neni, përfshinë ngastrat kadastrale nr: 2779/1, 2779/2, 2779/3, 2774/3, 2774/1, 2778/9, 2778/10, 2778/5, 2778/6, 2778/3, 2778/4, 2778/7, 2778/11, 2780/1, 2780/2, 2781/1, si dhe pjesët e ngastrave nr: 7435, 2782/2, 2778/1,2778/2, dhe ka sipërfaqe të përgjithshme prej 4.65.35 ha.

Neni 3

Projekti ideor i planit të miratuar sipas këtij Vendimi, do të diskutohet në tubim të përbashkët me qytetarë dhe persona të tjerë juridikë me interes ligjor, brenda kufijëve të kompleksit të përfshirë me këtë plan, dhe pas shqyrtimeve profesionale nga Drejtorati i Planifikimit, i Urbanizmit dhe i Ndërtimtarisë i Komunës së Prishtinës dhe shqyrtimeve në trupat e Kuvendit të Komunës, i njëjti do t`i prezantohet për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Komunës të Prishtinës, në mënyrë që pas finalizimit dhe miratimit të tij përfundimtar, i njëjti do të shërbejë si bazë për hartimin e projektit zbatues.

Neni 4

Ekspozimi i të gjitha projekteve ideore të pjesëmarrësve në konkurs për shikim publik, në kohëzgjatje prej 30 ditësh, sipas Vendimit të Kuvendit të Komunës së Prishtinës nr. 01-35-19432, dt. 19.08.2005, zëvendëson procedurën e mëtejshme të shikimit publik të projektit ideor, të miratuar sipas këtij Vendimi.

Neni 5

Për realizimin e këtij Vendimi do të kujdeset Bordi i drejtorëve i Komunës së Prishtinës.

Drejtorati i Planifikimit, i Urbanizmit dhe i Ndërtimtarisë i Komunës së Prishtinës do të kryejë veprime nga përgjegjësia e tij e caktuar për realizimin e këtij Vendimi.

Neni 6

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit të tij nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01.NR. 110-24901 DT. 28.10.2005

KRYETARI I KUVENDIT
Ismet Beqiri